




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “KRISTO ISAK” BERAT**



Nr. 5 Prot

Berat, më: __. __. 2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse

Drejtorisë së marrëdhënieve me publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhezimit nr. 14 date 27.05.2021, Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional " Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak” ju njofton për krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësuës:

- 1- Mësimdhënës i formimit i praktik , drejtimi Hoteleri-turizëm, me kohë të plotë – 2 (dy) mësuës.

I-Aplikantët për mësimdhënës të kulturës profesionale të ofruesit e AFP-së duhet të përmbushin këto kritere:

1.1 Kritere të përgjithshme:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivim.



Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë & praktikës profesionale në ofruesit e AFP-ë, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

II. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass,
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës... 20.09.2023

DREJTORI I SHKOLLËS

Ferik KOÇI

